



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 139

Tiranë – E premte, 10 shtator 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 64/2021, datë 10.9.2021	Për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit..... 13743
Urdhër i ministrit të Mbrojtjes nr. 876, datë 25.6.2021	Për delegim kompetencash për nënshkrimin e praktikave për dhënie ndihme financiare për ushtarakët e Forcave të Armatosura..... 13743
Urdhër i ministrit të Mbrojtjes nr. 877, datë 25.6. 2021	Për delegim kompetence..... 13743
Urdhër i ministrit të Mbrojtjes nr. 878, datë 25.6. 2021	Për delegim kompetencash për nënshkrimin e urdhrave për dhënie pagese papunësie për bashkëshorten/in e ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura..... 13744
Urdhër ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 353, datë 1.9.2021	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 243, datë 8.6.2021, të ndryshuar..... 13744
Urdhër ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 354, datë 2.9.2021	Për përditësimin e urdhrit të ministrit nr. 72, datë 2.3.2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, të ndryshuar.. 13744

**VENDIM
Nr. 64/2021****PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË
KUVENDIT**

Në mbështetje të neneve 75, pika 1, dhe 78 të Kushtetutës, si dhe të neneve 6 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Deputetja Lindita Nikolla zgjidhet në detyrën e Kryetares së Kuvendit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARJA
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 10.9.2021

**URDHËR
Nr. 876, datë 25.6.2021****PËR DELEGIM KOMPETENCASH PËR
NËNSHKRIMIN E PRAKTIKAVE PËR
DHËNIE NDIHME FINANCIARE PËR
USHTARAKËT E FORCAVE TË
ARMATOSURA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të germës “F”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, datë 26.6.2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 30, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për nënshkrimin e praktikave për dhënien e ndihmave financiare të menjëhershme për ushtarakët e Forcave të Armatosura, me propozim të Shefit të Shtabit të

Përgjithshëm të FA-së, te zëvendësministri i Mbrojtjes, znj. Dallëndyshe Bici.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për zbatimin e këtij urdhri.

3. Urdhri nr. 462, datë 16.3.2015, i Ministrit të Mbrojtjes, “Për delegim kompetencash për dhënien e ndihmës financiare për ushtarakët e Forcave të Armatosura”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I MBROJTJES
Niko Peleshi**

**URDHËR
Nr. 877, datë 25.6.2021****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të germës “F”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, datë 26.6.2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Zëvendësministrit të Mbrojtjes, znj. Dallëndyshe Bici, i delegohet kompetenca, për:

- nënshkrimin e autorizimeve për përfaqësimin e Ministrisë së Mbrojtjes përpara gjykatave, në çështjet në të cilat Ministria e Mbrojtjes është palë;

- nënshkrimin e ankimeve, rekurseve, kërkesave për rishikim, kundërankimeve, kundërrekrurseve, të cilat ushtrohen kundër vendimeve në të cilat Ministria e Mbrojtjes ka qenë palë ndërgjyqëse;

- nënshkrimin e padive, kundërpadive, kërkesave për sigurim padie, kërkesave për pezullim ekzekutim vendimi gjyqësor, të cilat ushtrohen nga Ministria e Mbrojtjes.

2. Të gjitha aktet e nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij urdhri dhe që janë nxjerrë në zbatim të urdhrit nr. 1905, datë 20.10.2017, të Ministrit të Mbrojtjes, “Për delegim kompetence”, do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në përfundimin e procesit gjyqësor përkatës.



3. Ngarkohet zëvendësministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij urdhri.

4. Urdhri nr. 1905, datë 20.10.2017, i ministrit të Mbrojtjes, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Niko Peleshi

URDHËR
Nr. 878, datë 25.6. 2021

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH PËR
NËNSHKRIMIN E URDHRAVE PËR
DHËNIE PAGESE PAPUNËSIE PËR
BASHKËSHORTEN/IN E USHTARAKUT
AKTIV TË FORCAVE TË ARMATOSURA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të germës “P”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, datë 26.6.2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 37, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 854, datë 17.12.2004, “Për kriteret dhe masën e përfutimit të pagesës së papunësisë për bashkëshortin/en e ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për nënshkrimin e urdhrave për dhënie dhe ndërprerje të pagesës së papunësisë për bashkëshortin/en e ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura, te zëvendësministri i Mbrojtjes, znj. Dallëndyshe Bici.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij urdhri.

3. Urdhri nr. 1271, datë 20.8.2018, i ministrit të Mbrojtjes, “Për delegim kompetencash për nënshkrimin e urdhrave për dhënie pagese papunësie për bashkëshortin/en e ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura”, shfuqizohet.

Faqe | 13744

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Niko Peleshi

URDHËR
Nr. 353, datë 1.9.2021

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR.
243, DATË 8.6.2021, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të Kodit të Procedurave Administrative,

URDHËROJ:

1. Urdhri nr. 243, datë 8.6.2021, “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla”, të ndryshuar, i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural shfuqizohet.

2. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi

URDHËR
Nr. 354, datë 2.9.2021

**PËR PËRDITËSIMIN E URDHRIT TË
MINISTRIT NR. 72, DATË 2.3.2017, “PËR
MIRATIMIN E LËNDËVE VEPRUESE NË
PËRMBAJTJE TË PMB-ve”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”,



URDHËROJ:

1. Në urdhrin e ministrit nr. 72, datë 2.3.2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, të ndryshuar, bëhet përditësimi me ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) në listën 2, miratohen për shtim 2 (dy) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

b) rinovohen regjistrimet për 3 (tri) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

c) zgjaten afatet e regjistrimit për 46 (dyzet e gjashtë) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

ç) hiqen 2 (dy) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

d) zëvendësohen kushtet e lëndës vepruese të kolona “Dispozitat specifike”, për 1 (një) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ky përditësim të pasqyrohet në dokumentet e regjistrimit të PMB-ve, të regjistruara.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi

1. MIRATOHEN PËR SHTIM NË LISTËN 2, LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

Nr.	Emri i zakonshëm dhe numri i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Aplikant	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	Pepino Mosaic Virus , shtimi i BE-së, izolimi i butë Abp1.	Nuk aplikohet	Nikotina e papastër nuk duhet të tejkalojë vlerat e mëposhtme në materialin teknik: - max 0,005 mg/L në Abp1 TK; - max $3,87 \times 10^{-5}$ mg/kg në MPCP. (Nikotina është raportuar të jetë e pranishme në bimët e domates, prandaj, pasi agjenti mikrobik i kontrollit të dëmtuesve (MPCA) prodhohet në bimët e domates, nikotina është e pranishme si pasojë e metodës së prodhimit).	Abiopep Plant Health SL	28.6.2021	28.6.2036	Të kushtohet vëmendje e veçantë në: a) mirëmbajtjen e rreptë të kushteve mjedisore dhe analizave të kontrollit të cilësisë gjatë procesit të prodhimit që duhet të sigurohet nga prodhuesi, në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kufijve të ndotjes mikrobiologjike; b) mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve, duke marrë parasysh që mikroorganizmat në vetvete konsiderohen si sensibilizues të mundshëm, duke siguruar që pajisjet mbrojtëse personale të përfshihen si kusht i përdorimit.
2	Pepino Mosaic Virus , shtimi i CH2, izolimi i butë Abp2.	Nuk aplikohet	Nikotina e papastër nuk duhet të tejkalojë vlerat e mëposhtme në materialin teknik: - max 0,007 mg/L në Abp2 TK; - max $3,87 \times 10^{-5}$ mg/kg në MPCP. (Nikotina është raportuar të jetë e pranishme në bimët e domates, prandaj, pasi agjenti mikrobik i kontrollit të dëmtuesve (MPCA) prodhohet në bimët e domates, nikotina është e pranishme si pasojë e metodës së prodhimit).	Abiopep Plant Health SL	28.6.2021	28.6.2036	Të kushtohet vëmendje e veçantë në: a) mirëmbajtjen e rreptë të kushteve mjedisore dhe analizave të kontrollit të cilësisë gjatë procesit të prodhimit që duhet të sigurohet nga prodhuesi, në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kufijve të ndotjes mikrobiologjike; b) mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve, duke marrë parasysh që mikroorganizmat në vetvete konsiderohen si sensibilizues të mundshëm, duke siguruar që pajisjet mbrojtëse personale të përfshihen si kusht i përdorimit.



2. RINOVHET REGJISTRIMI (RIREGJISTRIMI) PËR LËNDËT VEPRUESE, SI MË POSHTË:

Nr.	Emri i zakonshëm dhe numri i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	Cyazofamid CAS Nr: 120116-88-3 CIPAC Nr: 653	4-chloro-2-cyano-N,N-dimethyl-5-p-tolylimidazole-1-sulfonamide	≥ 935 g/kg	1.8.2021	31.7.2036	Të kushtohet vëmendje e veçantë në: (a) specifikimin e materialit teknik të prodhuar; (b) ndikimin e përpunimit në vlerësimin e rrezikut të konsumatorit; (c) mbrojtjen e artropodëve dhe krimbave të tokës jo të synuar. Aplikuesi të paraqesë informacion konfirmues në lidhje me efektin e proceseve të trajtimit të ujit në natyrën e mbetjeve të pranishme në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, kur uji sipërfaqësor ose nëntokësor nxirret për ujë të pijshëm.
2	Streptomyces <i>shtami K61</i>	Nuk aplikohet	Jo papastërti	1.7.2021	30.6.2036	Të kushtohet vëmendje e veçantë për mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve, duke marrë parasysh që mikroorganizmat konsiderohen si sensibilizues të mundshëm dhe duhet të sigurojnë që pajisjet mbrojtëse personale të përfshihen si kusht i përdorimit. Prodhuuesit duhet të sigurojnë mirëmbajtje të rreptë të kushteve mjedisore dhe analizën e kontrollit të cilësisë gjatë procesit të prodhimit.
3	Clopyralid CAS Nr: 1702-17-6 CIPAC Nr: 455	3,6-dichloropyridine-2-carboxylic acid 3,6-dichloropicolinic acid	≥ 950 g/kg	1.10.2021	30.9.2036	Të kushtohet vëmendje e veçantë për: - specifikimin e materialit teknik të prodhuar; - mbrojtjen e operatorëve, duke siguruar që kushtet e përdorimit për operatorët përfshijnë aplikimin e pajisjeve mbrojtëse personale; - praninë e mundshme të mbetjeve të klopivalidit në kulturat qarkulluese; - transferimin e mundshëm të mbetjeve të klopivalidit nëpërmjet përzierjes së plehut ose plehut të kafshëve, ushqimi i të cilave buron nga zonat e trajtuara, për të shmangur dëmtimin e kulturave të ndjeshme; - mbrojtjen e ujërave nëntokësore në kushte të cënueshme. Kushtet e përdorimit përfshijnë masa zbutëse të rrezikut, kur është e përshtatshme.

3. ZGJATEN AFATET E REGJISTRIMIT PËR LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

- Deri më 31 maj 2021:

1. Flutriafol

Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

- Deri më 31 maj 2022:

1. Heptamaloxyloglucan

2. Flurochloridone

Gjithsej: 2 lëndë vepruese.

- Deri më 31 korrik 2022:

1. Famoxadone

2. Flumioxazine

3. Phenmedipham

4. S-metolachlor

5. Bifenazate

6. Milbemectin

7. Ethephon

8. Captan

9. Folpet

10. Formetanate

11. Dimethomorph

12. Metribuzin

13. Phosmet

14. Propamocarb

15. Pirimiphos-methyl

16. Beflubutamid

17. Benti avari carb

18. Boscalid

19. Fluoxastrobin



20. *Paecilomyces lilacinus* strain 251

21. Prothioconazole

22. Metazachlor

Gjithsej: 22 lëndë vepruese.

- Deri më 31 gusht 2022:

1. Aluminium ammonium sulphate

2. Aluminium silicate

3. Calcium carbonate

4. Carbon dioxide

5. Ekstrakt nga bima e çajit

6. Mbetjet e distilimit të yndyrës (Fat distillation residues)

7. Acide yndyrore C7 deri C20 (Fatty acids C7 to C20)

8. Gibberellic acid

9. Gibberellin

10. Proteinat e hidrolizuara (Hydrolysed proteins)

11. Sulfat hekuri (Iron sulphate)

12. Vajra bimore/vaj i farave të kolzes (Plant oils/rape seed oil)

13. Potassium hydrogen carbonate

14. Rërë kuarci (Quartz sand)

15. Vaji i peshkut (Fish oil)

16. Repelentë me origjinë shtazore ose bimore/yndyra e deleve (Repellents by smell of animal or plant origin/sheep fat)

17. Feromonet me zinxhir të drejtë të Lepidoptereve (Straight Chain Lepidopteran Pheromones)

18. Cymoxanil

19. Tebuconazole

20. Urea

Gjithsej: 20 lëndë vepruese.

- Deri më 31 janar 2023:

1. Adoxophyes orana granulovirus

Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

TOTALI: 46 (dyzet e gjashtë) lëndë vepruese.

4. HIQEN LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

1. **Alpha-cypermethrin.** Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë alpha-cypermethrin, brenda datës 7 dhjetor 2021.

2. **Famoxadone.** Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë famoxadone, brenda datës 16 mars 2022.

Gjithsej: 2 (dy) lëndë vepruese.

5. ZËVENDËSOHEN KUSHTET E LËNDËVE VEPRUESE TE KOLONA “DISPOZITAT SPECIFIKE”, SI MË POSHTË:

1. **Terbuthylazine.** Zëvendësohen kushtet e lëndës vepruese te kolona “Dispozitat specifike”, pjesa B, si vijon:

Nr.	Emri i zakonshëm dhe numri identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	Terbuthylazine CAS Nr: 5915-41-3 CIPAC Nr: 234	N2-tert-butyl-6-chloro-N4-ethyl-1,3,5-triazine-2,4-diamine	≥ 950 g/kg Papastërtitë e mëposhtme janë toksikologjike shqetësuese dhe nuk duhet të kalojnë nivelet e mëposhtme në materialin teknik: - Propazine: max. 9 g/kg, - Atrazine: max. 1 g/kg, - Simazine: max. 9 g/kg.	1.1.2012	31.12.2024	PJESA A Vetëm përdorimet si herbicide mund të autorizohen. Përdorimi do të kufizohet në një aplikim çdo tre vjet në të njëjtën fushë në një dozë maksimale prej 850 g terbuthilazine/ha. PJESA B Të kushtohet vëmendje e veçantë në: - vlerësimin e rrezikut të konsumatorit nga ekspozimi ndaj metabolitëve të terbuthilazinës; - mbrojtjen e ujërave nëntokësore, kur substanca aktive aplikohet në rajone me tokë dhe/ose kushte klimatike të prekshme; - rrezikun për gjitarët dhe krimbat e tokës. Kushtet e përdorimit përfshijnë masat për zbutjen e rrezikut dhe detyrimin për të kryer programe monitorimi për të verifikuar ndotjen e mundshme të ujërave nëntokësore në zonat e cënueshme, aty ku është e përshtatshme.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 32 lekë